

Engla



17.02/2003

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRI

MIRATOHET

Sokol Olldash

SOKOL OLLDASHI
MINISTER

UDHEZIM

Nr 15, Date 14/10/2008

“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmerisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të avionëve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të mirembajtjes dhe prodhuesve”

Ne zbatim të Nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9658, datë 18/12/2006 për ratifikimin e Marrëveshjes Shumepalëshe ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anetare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Perkoheshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Perbashkët Aviacionit Europian,

Udhezoi:

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimet

1. Ky udhëzim, përcakton kushte të përbashkëta teknike dhe procedura administrative për certifikimin e vlefshmerisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duke specifikuar:

- (i) lëshimin e çertifikatave tip, çertifikatave tip të kufizuara, çertifikatave tip shtesë dhe ndryshime në ato çertifikata;
- (ii) lëshimin e çertifikatave të vlefshmerisë ajrore, çertifikata të kufizuara të vlefshmerisë ajrore, leje fluturimi dhe çertifikata të autorizuara të shitjes;
- (iii) dhënien e miratimit për programin e mirembajtjes;
- (iv) paraqitjen e përputhshmërisë me kërkesat për mbrojtjen mjedisore;
- (v) lëshimin e çertifikatave për zhurmën;
- (vi) identifikimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

3. Miratimi për organizatat prodhuese i dhëne ose i njohur nga DPAC ne përputhje me kërkesat dhe procedurat e APA para dates se hyrjes ne fuqi te ketij udhezimi konsiderohet ne përputhje me këte udhezim. Ne këte rast, periudha për mbylljen e konkluzioneve te nivelit te dytë, te përmendura ne Nenpjesën G te Pjesës 21 nuk duhet ta kalojne një vit kur këto konkluzione kane lidhje me ndryshimet ne KPA e zbatueshme më parë.

4. Organizatat duhet te demonstrojne aftesine e tyre sipas kësaj Rregulloreje para vitit 2010.

5. Derisa një organizatë te kete demonstruar aftesine e vet sipas Nenpjesëve F dhe G te Pjesës 21, deklaratat e konformitetit dhe çertifikatat e autorizuara te lëshuara nga organizata sipas normave kombëtare ne fuqi do te konsiderohen se jane lëshuar ne përputhje me këte Udhezim.

6. Përsa i përket organizatave për te cilat po ndiqet një procedure për miratim te organizatave prodhuese përmës DPAC ne daten e hyrjes ne fuqi te ketij udhezimi sipas procedurave te zbatueshme te APA:

(a) 21A.134 e Pjesës 21 nuk do te zbatohet;

Neni 5

Hyrja ne fuqi

1. Ky udhezim hyn ne fuqi ne daten _____.

Ky udhezim është detyrues ne teresine e tij dhe ngarkohet DPAC per te garantuar zbatimin.

SHTOJCE

Pjesa 21

Certifikimi i avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve te lidhura me te dhe certifikimi i organizatave te mirembajtjes dhe prodhuese

21.1 Te përgjithshme

Për qëllimin e kësaj Pjesë, "Autoriteti Kompetent" nenkupton:

(a) për organizatat që vendin kryesor te biznesit e kane ne Shqiperi, DPAC; ose Agjensia nëse kërkohet kështu nga DPAC; ose

(b) për organizata që vendin kryesor te biznesit e kane ne një Shtet joantar, Agjensia.

SEKSIONI A

KËRKESAT PËR APLIKANTET DHE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E FITUARA

NENPJESA A

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

21A. 1 Qëllimi

- (vii) certifikimin e pjesëve dhe pajisjeve të caktuara;
- (viii) certifikimin e organizatave të mirembajtjes dhe të prodhimit;
- (ix) nxjerrjen e direktivave të vlefshmerisë ajrore;

2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) “APA” nënkupton “Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit”
- (b) “KPA” nënkupton “Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit”
- (c) “Pjesa 21” nënkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin e avionit ose të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që kanë të bëjnë me të si dhe të organizatave të mirembajtjeve dhe prodhuese që ndodhen në aneksin e kësaj Rregulloreje.
- (d) “Pjesa M” nënkupton kushtet e zbatueshme për vazhdueshmerinë e vlefshmerisë ajrore të miratuara në përputhje me Rregulloren bazë.

Neni 2

Certifikimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve

1. Për produktet, pjesët dhe pajisjet lëshohen certifikata sikurse specifikohet në Pjesën 21.

2. Nepërmjet heqjes dorë nga paragrafi 1, avionet duke përfshirë çdo produkt, pjesë apo pajisje të instaluar, të cilat nuk janë të regjistruara në Shqipëri ose ndonjë Shtet Anetar të BE, përjashtohen nga dispozitat e Nenpjesëve H dhe I, të Pjesës 21.

3. Përsa i përket produkteve që kanë një certifikatë tip të lëshuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, nga DPAC do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Certifikata tip e një produkti të tillë do të konsiderohet se është lëshuar në përputhje me këto Rregullore kur:

(i) baza e certifikatës tip të tij është:

- baza e certifikimit tip APA, ose EASA, për produkte që janë certifikuar sipas procedurave të APA, ose EASA sikurse është përcaktuar në fletën APA/ EASA për të dhënat e tyre; ose
- për produkte të tjera, baza e certifikimit tip sikurse përcaktohet në fletën e të dhënave të Shtetit të projektimit, nëse ky Shtet është:
- një Shtet Anetar i BE, përveçse kur, duke marrë parasysh kodet e aftesisë për të fluturuar të përdorura dhe përvojën e shërbimit, kjo lloj baze e certifikimit tip nuk ofron një nivel sigurie të njëjtte me atë që kërkohet nga ku udhezim; ose
- një Shtet me të cilin Shqipëria ka lidhur një marrëveshje dypalëshe për kodet e vlefshmerisë ajrore, përveçse kur këto kode të vlefshmerisë ajrore

(c) Baza e çertifikatës tip që zbatohet do të përcaktohet nga APA ose kur është e zbatueshme, DPAC ne datën e aplikimit për miratimin e ndryshimit;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nëpërmjet procedurave të APA ose të DPAC do të konsiderohen së janë nxjerrë në zbatim të 21A.103 (a) dhe (b) e Pjesës 21;

6. Përsa i përket certifikatës tip shtesë për të cilat ka nisur një proces certifikimi nga DPAC ne datën e hyrjes në fuqi të këtij udhezimi sipas procedurave të APA për certifikatat shtesë; dhe përsa i përket ndryshimeve të mëdha të produkteve, të propozuara nga persona të ndryshëm nga mbajtësit i certifikatës tip të produkteve për të cilat një proces certifikimi po kryhet nga DPAC ne datën e hyrjes në fuqi të këtij udhezimi sipas procedurave kombëtare të zbatueshme:

(a) nëse një proces certifikimi po kryhet nga disa Shtete Antare, si reference do të përdoret projekti më i përparuar.

(b) 21A.113 (a) dhe (b) e Pjesës 21 nuk do të zbatohet;

(c) baza e zbatueshme për certifikimin do të jetë ajo që është përcaktuar nga APA ose, kur është e zbatueshme, DPAC ne datën e aplikimit për certifikatë tip shtesë ose për miratimin e ndryshimit të madh;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nëpërmjet procedurave të APA ose të DPAC do të konsiderohen së janë nxjerrë në zbatim të 21A.115 (a) e Pjesës 21;

7. Përsa i përket produkteve që kanë certifikatë tip kombëtare ose të barazvlefshme me të dhe për të cilat procesi i miratimit për një program të rëndësishëm mirembajtje që kryhet nga DPAC nuk është finalizuar në kohën kur çertifikata tip përcaktohet në përputhje me këtë Udhezim, rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra sipas procedurave të APA ose Shtetit Antar do të konsiderohen se janë nxjerrë nga DPAC në zbatim të 21A.433 (a) të Pjesës 21.

8. Përsa i përket pjesëve dhe pajisjeve për të cilat kryhet një proces miratimi ose autorizimi në datën e hyrjes në fuqi:

(a) nëse një proces autorizimi kryhet nga disa Shtete Antare, si reference do të përdoret projekti më i përparuar;

(b) 21A. 603 e Pjesës 21 nuk do të zbatohet;

(c) kërkesat e zbatueshme për të dhënat sipas 21A.605 (b) të Pjesës 21 do të jenë ato të përcaktuara nga DPAC ne datën e aplikimit për miratim ose autorizim;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nga Shtetit Antar përkates do të konsiderohen së janë nxjerrë në zbatim të 21A.606 (b) të Pjesës 21;

- (vii) certifikimin e pjesëve dhe pajisjeve te caktuara;
- (viii) certifikimin e organizatave te mirembajtjes dhe te prodhimit;
- (ix) nxjerrjen e direktivave te vlefshmerise ajrore;

2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) “APA” nenkupton “Autoritetet e Përbashkëta te Aviacionit”
- (b) “KPA” nenkupton “Kërkesat e Përbashkëta te Aviacionit”
- (c) “Pjesa 21” nenkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin e avionit ose te produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që kane te bëjne me te si dhe te organizatave te mirembajtjeve dhe prodhuese që ndodhen ne aneksin e kësaj Rregulloreje.
- (d) “Pjesa M” nenkupton kushtet e zbatueshme për vazhdueshmerine e vlefshmerise ajrore te miratuara ne përputhje me Rregulloren bazë.

Neni 2

Certifikimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve

1. Për produktet, pjesët dhe pajisjet lëshohen certifikata sikurse specifikohet ne Pjesën 21.

2. Nepërmjet heqjes dorë nga paragrafi 1, avionet duke përfshirë çdo produkt, pjesë apo pajisje te instaluar, te cilat nuk jane te regjistruara ne Shqiperi ose ndonjë Shtet Anetar te BE, përjashtohen nga dispozitat e Nenpjesëve H dhe I, te Pjesës 21.

3. Përsa i përket produkteve që kane një certifikate tip te lëshuar para hyrjes ne fuqi te kesaj rregulloreje, nga DPAC do te zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Çertifikata tip e një produkti te tillë do te konsiderohet se është lëshuar ne përputhje me këte Rregullore kur:

(i) baza e certifikates tip te tij është:

- baza e certifikimit tip APA, ose EASA, për produkte që jane certifikuar sipas procedurave te APA, ose EASA sikurse është përcaktuar ne fleten APA/ EASA për te dhënat e tyre; ose
- për produkte te tjera, baza e certifikimit tip sikurse përcaktohet ne fleten e te dhënave te Shtetit te projektimit, nëse ky Shtet është:
- një Shtet Antar i BE, përveçse kur, duke marre parasysh kodet e aftesisë për te fluturuar te përdorura dhe përvojën e shërbimit, kjo lloj baze e certifikimit tip nuk ofron një nivel sigurie te njëjte me ate që kërkohet nga ku udhezim; ose
- një Shtet me te cilin Shqiperia ka lidhur një marrëveshje dypalëshe për kodet e vlefshmerise ajrore, përveçse kur këto kode te vlefshmerise ajrore

(c) Baza e çertifikatës tip që zbatohet do të përcaktohet nga APA ose kur është e zbatueshme, DPAC ne datën e aplikimit për miratimin e ndryshimit;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nëpërmjet procedurave të APA ose të DPAC do të konsiderohen se janë nxjerrë në zbatim të 21A.103 (a) dhe (b) e Pjesës 21;

6. Përsa i përket çertifikatës tip shtesë për të cilat ka nisur një proces certifikimi nga DPAC ne datën e hyrjes në fuqi të këtij udhezimi sipas procedurave të APA për çertifikatat shtesë; dhe përsa i përket ndryshimeve të mëdha të produkteve, të propozuara nga persona të ndryshëm nga mbajtësit i çertifikatës tip të produkteve për të cilat një proces certifikimi po kryhet nga DPAC ne datën e hyrjes në fuqi të këtij udhezimi sipas procedurave kombëtare të zbatueshme:

(a) nëse një proces certifikimi po kryhet nga disa Shtete Antare, si referencë do të përdoret projekti më i përparuar.

(b) 21A.113 (a) dhe (b) e Pjesës 21 nuk do të zbatohet;

(c) baza e zbatueshme për certifikimin do të jetë ajo që është përcaktuar nga APA ose, kur është e zbatueshme, DPAC ne datën e aplikimit për çertifikatë tip shtesë ose për miratimin e ndryshimit të madh;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nëpërmjet procedurave të APA ose të DPAC do të konsiderohen se janë nxjerrë në zbatim të 21A.115 (a) e Pjesës 21;

7. Përsa i përket produkteve që kanë çertifikatë tip kombëtare ose të barazvlefshme me të dhe për të cilat procesi i miratimit për një program të rëndësishëm mirembajtjeje që kryhet nga DPAC nuk është finalizuar në kohën kur çertifikata tip përcaktohet në përputhje me këtë Udhezim, rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra sipas procedurave të APA ose Shtetit Antar do të konsiderohen se janë nxjerrë nga DPAC në zbatim të 21A.433 (a) të Pjesës 21.

8. Përsa i përket pjesëve dhe pajisjeve për të cilat kryhet një proces miratimi ose autorizimi në datën e hyrjes në fuqi:

(a) nëse një proces autorizimi kryhet nga disa Shtete Antare, si referencë do të përdoret projekti më i përparuar;

(b) 21A. 603 e Pjesës 21 nuk do të zbatohet;

(c) kërkesat e zbatueshme për të dhënat sipas 21A.605 (b) të Pjesës 21 do të jenë ato të përcaktuara nga DPAC ne datën e aplikimit për miratim ose autorizim;

(d) Rezultatet e përputhshmërisë të nxjerra nga Shtetit Antar përkates do të konsiderohen se janë nxjerrë në zbatim të 21A.606 (b) të Pjesës 21;

mbajtësi i një çertifikatë tip, çertifikatë tip te kufizuar, çertifikatë tip shtesë, autorizimit te UEST, miratimit te një programi riparimi te rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to që konsiderohen se janë nxjerrë ne përputhje me këte Rregullore, ose sipas rastit, prodhuesi do te hetojë mbi shkakun e mangësisë dhe do t'i raportojë DPAC/ Agjencisë rezultatet e hetimit dhe ndonjë veprim që po ndërmerr ose që propozon te ndërmarrë për te korrigjuar ate mangësi.

2. Nëse Agjencia arrin ne konkluzionin se duhen marrë masa për ta korrigjuar mangësinë, mbajtësi i një çertifikatë tip, çertifikatë tip te kufizuar, çertifikatë tip shtesë, autorizimit te UEST, miratimit te një programi riparimi te rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to që konsiderohen se janë nxjerrë ne përputhje me këte Udhezim, ose sipas rastit, prodhuesi do te paraqesin te dhënat përkatëse prane Agjencisë.

21A.3B Direktivat për vlefshmerine ajrore

(a) Një direktivë për vlefshmerise ajrore është një dokument i lëshuar ose i miratuar nga Agjencia (EASA) i cili urdhëron kryerjen e punimeve ne një avion për te kthyer një nivel te pranueshëm sigurie, kur provat tregojne se niveli i sigurisë së atij avioni ne te kundërt do te kompromentohej.

(b) Agjencia nxjerr direktiva për vlefshmerise ajrore kur:

1. Agjencia ka përcaktuar se ekziston një kusht i pasigurte ne një avion si pasojë e një mangësie ne ate avion, motor, helikë, pjesë ose pajisje te instaluar ne këte avion; dhe

2. Ai kusht mund te ekzistojë ose te zhvillohet ne një avion tjetër.

(c) Kur një direktive për vlefshmerine ajrore duhet te lëshohet nga Agjencia për te korrigjuar kushtin e pasigurte te përmendur ne paragrafin (b), ose për te kërkuar kryerjen e një inspektimi, mbajtësi i një çertifikatë tip, çertifikatë tip te kufizuar, çertifikatë tip shtesë, autorizimit te UEST, miratimit te një programi riparimi te rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to që konsiderohen se janë nxjerrë ne përputhje me këte Udhezim:

1. Propozon veprimin e përshtatshëm korrigjues ose inspektimet e kërkua, ose te dyja dhe paraqet prane Agjencisë hollësira te këtyre propozimeve për te marrë miratimin e tyre.

2. Ne vijim te miratimit nga Agjencia te propozimit te përmendur ne nenparagrafin (1), vë ne dispozicion te te gjithë operatorëve te njohur ose te te gjithë atyre që zoterojne produktin, pjesën ose pajisjen dhe, nëse kërkohet edhe te ndonjë përsone i cilit i kërkohet te veprojnë ne përputhje me direktivën, te dhënat e duhura përshkruese dhe udhëzimet e realizimit.

(d) Direktiva për vlefshmerine ajrore përmban jo më pak se informacioni i mëposhtem:

1. Një identifikim te kushtit te pasigurte;
2. Një identifikim te avionit te prekur;
3. Veprimin (Veprimet) e nevojshme
4. Kohën brënda së cilës duhet te kryhen veprimi (veprimet);
5. Daten e hyrjes ne fuqi.

21A.4 Koordinimi ndërmjet mirembajtjes dhe prodhimit

Secili mbajtës i një çertifikatë tip, çertifikatë tip te kufizuar, çertifikatë tip shtesë, autorizim te UEST, miratimit te ndryshimit te programit tip ose miratimit te programit

te mirembajtjes, bashkëpunon me organizatën prodhuese sipas nevojave për te siguruar:

- (a) Koordinimin e kënaqshëm të programit të mirembajtjes dhe prodhimit të kërkuar sipas rastit në 21A.122 ose 21A.133 ose 21A.165 (c) (2) dhe
- (b) Mbështetjen e duhur të vazhdueshmerisë të vlefshmerisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes.

NENPJESA B

=====

ÇERTIFIKATAT TIP DHE ÇERTIFIKATAT TIP TE KUFIZUARA

21A.11 Qëllimi

Kjo nenpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave tip për produktet dhe certifikatat tip të kufizuara për avionet dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikanteve për certifikata si dhe të mbajtesve të atyre certifikatave.

21A.13 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar ose është në proces të sipër të demonstrimit të aftësisë së tij në përputhje me 21A.14 ka të drejtën të merret në konsideratë si aplikant për një certifikatë tip ose certifikatë tip të kufizuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë Nenpjesë.

21A14. Demonstrimi i aftësive

(a) Secila organizatë që aplikon për një certifikatë tip ose certifikatë tip të kufizuar demonstron aftësinë e saj duke qënë në zotërim të miratimit të organizatës mirembajtëse, të lëshuar nga DPAC në përputhje me Nenpjesën J.

(b) Nepërmjet heqjes dorë nga paragrafi (a), si një procedurë alternative ndaj demonstrimit të aftësive, një aplikant mund të kërkojë të bjerë dakord me DPAC për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikën e burimit specifikë dhe radhën e veprimeve të nevojshme për të qënë në përputhje me këtë Pjesë, kur produkti është një nga të mëposhtmit:

1. një aeroplan shumë i lehtë ose avion i hapur me helike, një planer ose një planer me energji, një balonë, një avion termik;
2. një aeroplan i vogël me të gjithë elementet e mëposhtem:
 - (i) Motor me një piston, me aspirim natyral, me Fuqinë Maksimale të Ngritjes jo më të madhe se 250 hp (kuaj fuqi)
 - (ii) Konfigurim konvencional
 - (iii) Material dhe strukturë konvencionale
 - (iv) Fluturimet sipas VFR, jashtë kushteve të ngritjes
 - (v) Numri maksimal i vendeve është 4 duke përfshirë pilotin dhe masën maksimale për ngritje deri në 3000 libra ose 1361 kilogramë;
 - (vi) Kabine e papresuar;
 - (vii) Pult komandimi jo elektrik;
 - (viii) Fluturime baze akrobatike të kufizuara deri në +6/-3g; ose
3. një motor me piston; ose

mbrojtjen mjedisore dhe i jep DPAC mjetet nepërmjet te cilave kjo përputhshmëri është treguar.

(b) Aplikanti deklaron se ka treguar përputhshmërine me gjithë bazën për certifikimin tip dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore.

(c) Kur aplikanti ka një miratim të përshtatshëm të një organizatë projektuese, deklarata e paragrafit (b) bëhet sipas dispozitave të Nenpjesës J.

21A.21 Lëshimi i një certifikatë tip

Aplikanti ka të drejtën t'i lëshohet një certifikatë tip nga DPAC pasi:

(a) ka demonstruar aftësitë e tij në përputhje me 21A.14;

(b) ka paraqitur deklaratën e përmendur në 21A.20(b); dhe

(c) është demonstruar se:

1. Produkti që duhet certifikuar përmbush bazën e zbatueshme të bazës për certifikimin tip si dhe kriteret e mbrojtjes mjedisore të përcaktuara në përputhje me 21A.17 dhe 21A.18;

2. Dispozitat e aftësisë për të fluturuar të cilat nuk përmbushen, kompensohen nga faktorë që sigurojnë një nivel të barazvlefshëm sigurie;

3. Asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën të pasigurte për përdorimet për të cilat kërkohet certifikim; dhe

4. Aplikanti për certifikatë tip është shprehur qartë se është i përgatitur të përmbushë 21A.44.

(d) Në rastin e një certifikatë tip për avion, për motorin ose helikën, ose të dyja këto, nëse janë të instaluar në avion, të këtyre certifikatë tip të lëshuar ose përcaktuar në përputhje me këto Udhezime.

21A.23 Lëshimi i një certifikatë tip të kufizuar

(a) Për një avion që nuk përmbush dispozitat e 21A.21 (c), aplikanti ka të drejtën t'i lëshohet nga DPAC një certifikatë e kufizuar pasi:

1. të këtyre përmbushur bazën e përshtatshme për certifikimin tip të përcaktuar nga DPAC duke garantuar sigurinë e duhur në lidhje me qëllimin e përdorimit të avionit si dhe të këtyre përmbushur kriteret e zbatueshme të mbrojtjes mjedisore;

2. të këtyre shprehur qartë se është i përgatitur të përmbushë 21A.44.

(b) Motori ose helika, ose të dyja, kur janë të instaluar në avion:

1. Kane një certifikatë tip që është lëshuar ose përcaktuar në përputhje me këto Udhezime; ose

2. Është treguar se janë në përputhje me specifikimet e certifikimit që nevojiten për të garantuar një fluturim të sigurt të avionit.

21A.31 Projekti tip

(a) Projekti tip konsiston në:

1. Skicat dhe specifikimet, dhe një listë e atyre skicave dhe specifikimeve, që nevojiten për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e produktit që është demonstruar se është në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip dhe me kriteret për mbrojtjen mjedisore;

2. Informacione mbi materialet e proceset dhe mbi metodat e prodhimit e të montimit të produktit të nevojshme për të garantuar përshtatshmërinë e produktit;

3. Një seksion për kufizimet e miratuara të aftësisë për të fluturuar të udhëzimeve për aftësinë për të fluturuar të vazhdueshme sikurse përcaktohet nga kodi i zbatueshëm i vlefshmerisë ajrore; dhe

1. Për avionet që përfshijne motoret me turbine te një lloji që nuk është përdorur më parë ne një avion që ka certifikate tip, te pakten 300 orë pune me sasine e plote te motorëve që jane konform një certifikatë; dhe
2. Për te gjithë llojet e tjera te avioneve, te pakten 150 orë pune.

21A.41 Certifikata tip

Si certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar konsiderohen se përfshijne projektin tip, kufizimet e funksionimit, fleten e te dhënave te certifikates tip për aftesine për te fluturuar dhe emetimet e gazrave, bazën e zbatueshme te certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore me te cilat DPAC regjistron përputhshmërine dhe ndonjë kusht tjetër ose kufizimet e përcaktuara për produktin ne specifikimet e zbatueshme te certifikimit dhe ne kërkesat për mbrojtjen mjedisore. Certifikata tip e avionit dhe certifikata tip e kufizuar, përvec kësaj, përfshijne te dyja fleten e te dhënave te certifikimit tip për zhurmën. Fleta e te dhënave për certifikimin tip te motorit përfshin te dhënat për konformitetin për emetimin e gazrave.

21A.44 Detyrimet e mbajtësit

Secili mbajtës i certifikates tip ose certifikates tip te kufizuar:

(a) merr përsipër përgjegjësite e përcaktuara ne 21A.3, 21A.3B, 21A.4, 21A.55, 21A.57 dhe 21A.61; dhe për këte qëllim vazhdon te përmbushë kërkesat për t'u konsideruar

21A.47 Transferueshmëria

Transferimi i një certifikatë tip ose i një certifikatë tip te kufizuar mund te bëhet vetëm ndaj një përsoneit fizik ose juridik që është ne gjendje te marrë përsipër përgjegjësite sipas 21A.44, dhe për, këte qëllim, ka treguar aftesine e tij për t'u kualifikuar sipas kriterëve te 21A.14.

21A.51 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhduar

(a) Certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar lëshohen për kohëzgjatje te pakufizuar. Ato mbeten te vlefshme nëse:

1. Mbajtësi vazhdon te jetë ne përputhje me këte Pjesë; dhe

2. Certifikata nuk dorëzohet ose shfuqizohet sipas procedurave administrative te përcaktuara nga DPAC.

(b) Me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar i kthehet DPAC.

21A.55 Mbajtja e te dhënave

Te gjitha informacionet e nevojshme te projektimit, skicat dhe raportet e provave te realizuara, ruhen nga mbajtësi i certifikates tip ose i certifikates tip te kufizuar, ne dispozicion te DPAC, dhe do te mbahen ne mënyrë që te jepet informacioni i nevojshëm për te siguruar vazhdueshmerine e vlefshmerise ajrore dhe përputhshmërine me kërkesat e zbatueshme te produktit për mbrojtjen mjedisore.

21A.57 Manualet

më parë se data pararendëse ndaj dates së miratimit të ndryshimit në periudhën kohore të përcaktuar sipas këtij nenparagrafi për aplikimin origjinal për ndryshim.

21A.103 Dhënia e miratimit

(a) Aplikanti ka të drejtën të bëjë ndryshime të mëdha për një projekt të miratuar nga DPAC pasi:

1. të paraqesë deklaratën e përmendur në 21A.97 (a)(3); dhe

2. Tregohet se:

(i) Produkti i ndryshuar përmbush specifikimet e zbatueshme të çertifikimit dhe kërkesat e mbrotjes mjedisore, sikurse specifikohet në 21A.101;

(ii) Mospërmbushja e secilës dispozite të vlefshmerisë ajrore kompensohet nepërmjet faktorëve që sigurojnë një nivel të njëjtte sigurie; dhe

(iii) Asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën produktin të pasigurtë për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

(b) Një ndryshim i vogël miratohet vetëm në përputhje me 21A.95 nëse tregohet se produkti i ndryshuar përmbush specifikimet e zbatueshme të çertifikimit, sikurse specifikohet në 21A.101.

21A.105 Mbajtja e të dhënave

Për secilin ndryshim, informacionet që kanë lidhje me mirembajtjen, skicimin dhe relacionet e provave duke përfshirë të dhënat e inspektimeve për produktet e ndryshuara që testohen, mbahen nga aplikanti në dispozicion DPAC dhe ruhen në mënyrë që të jepet informacioni i nevojshëm për të siguruar vazhdueshmerinë e vlefshmerisë ajrore dhe në përputhje me kërkesat e zbatueshme të mbrotjes mjedisore të produktit të ndryshuar.

21A.107 Udhëzime për vazhdueshmerinë e vlefshmerisë ajrore

(a) Mbajtësi i një miratimi për një ndryshim të vogël të programit të mirembajtjes tip do të japë të paktën një set me ndryshimet përkatëse, nëse ka, për udhëzimet për vazhdueshmerinë e vlefshmerisë ajrore të produktit në të cilin do instalohet ndryshimi i vogël, të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të çertifikimit tip, për secilin zoterues të një ose më shumë motora avionesh, ose helika që pësojnë ndryshim, me lëvrimin e tyre ose me nxjerrjen e certifikates së parë për vlefshmerinë ajrore për avionin e prekur, cilado të ndodhë më vonë, dhe ato ndryshime t'ia vërë në dispozicion sipas kërkesës, edhe çdo personi tjetër i cili duhet të veprojë në përputhje me kushtet e atyre udhëzimeve.

(b) Përveç kësaj, modifikime të atyre ndryshimeve të udhëzimeve për vazhdueshmerinë e vlefshmerisë ajrore do të vihen në dispozicion të gjithë operatorëve të produkteve duke përfshirë edhe ndryshimet e vogla dhe sipas kërkesës do të vihen në dispozicion çdo personi që duhet të veprojë në përputhje me ndonjë nga ato udhëzime.

21A.109 Detyrimet dhe shenimi MEP

Mbajtësi i një miratimi për ndryshim të projektit tip do të:

(a) Marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në 21A.4, 21A.105 dhe 21A.107; dhe

(b) Konkluzione te nivelit te tretë jane çdo element ku, nepërmjet provave objektive, është identifikuar se ka probleme që mund te çojne ne mospërputhje sipas paragrafit (a).

(c) Pasi merret njoftimi për konkluzionet sipas 21B.143:

1. Ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te parë, mbajtësi i leter marrëveshjes demonstroi veprime korrigjuese ne përputhje me kërkesat e Autoritetit Kompetent brënda një periudhe prej jo më shumë se 21 dite pune pas marrjes së konfirmimit te konkluzioneve;

2. Ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te dytë, periudha e veprimeve korrigjuese e dhëne nga Autoriteti Kompetent do jetë e përshtatshme me natyrën e konkluzioneve por ne çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashte muaj. Ne disa rrethana dhe ne varësi te konkluzioneve, Autoriteti Kompetent mund ta zgjasë periudhën gjashte mujore ne një plan te kënaqshëm veprimi te masave korrigjuese për te cilin bihet dakord nga Autoriteti Kompetent.

3. Konkluzionet e nivelit te tretë nuk kërkojne që te ndërmerren veprime te menjëherëshme nga mbajtësi i leter marrëveshjes.

(d) ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te dytë, letra e marrëveshjes mund te jetë subjekt i një kufizimi te pjesshëm ose te plote, pezullimi dhe shfuqizimi sipas 21B.145 Mbajtësi i letrës së marrëveshjes konfirmon ne kohë marrjen e njoftimit te kufizimit, pezullimit ose te shfuqizimit te leter marrëveshjes.

21A.125C Kohëzgjatja dhe vazhdueshmeria e vlefshmerise

(a) Leter marrëveshja jepet për një kohëzgjatje te kufizuar prej jo më shumë se një viti. Ajo mbetet e vlefshme, përveçse kur:

1. Mbajtësi i leter marrëveshjes nuk tregon përputhshmërine me kërkesat e zbatueshme për këte Nenpjesë; ose

2. Ka prova se prodhuesi nuk mund te kete kontroll te kënaqshëm gjate prodhimit te produkteve, pjesëve ose pajisjeve, sipas marrëveshjes; ose

3. Prodhuesi nuk i përmbush më kërkesat e parashtruara ne 21A.122; ose

4. Leter Marrëveshja është dorëzuar, shfuqizuar ne përputhje me 21B.145 ose i ka mbaruar afati.

(b) Me t'u dorëzuar, anuluar ose me te mbaruar afati, Leter Marrëveshja i kthehet Autoritetit Kompetent.

21A.126 Sistemi i inspektimit te prodhimit

(a) Sistemi i inspektimit te prodhimit që kërkohet ne 21A.125 do te jetë një mjet për te përcaktuar se:

1. Materialet hyrëse dhe ato që blihen ose pjesët e nenkontraktuara, që përdoren ne produktin e përfunduar jane sikurse specifikohet ne te dhënat e zbatueshme te projektit.

2. Materialet hyrëse dhe ato që blihen ose pjesët e nenkontraktuara, identifikohen ashtu si duhet.

3. Proceset, teknikat e prodhimit dhe metodat e montimit që ndikojne cilësinë dhe sigurinë e produktit te përfunduar realizohen ne përputhje me specifikimet e pranuar nga Autoriteti Kompetent.

certifikates tip për çdo motor ose helikë me lëkundje për te përcaktuar nëse vepron si duhet ne te gjitha operacionet për te cilat e ka çertifikatën tip, për te verifikuar aspektet përkatëse te përputhshmërisë me 21A. 125(a).

21A.129 Detyrimet e prodhuesit

Secili prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj Nenpjesë:

(a) Vë ne dispozicion te Autoritetit Kompetent për inspektim çdo produkt, pjesë ose pajisje.

(b) Mban ne vendin e prodhimit te dhënat teknike dhe skicat e nevojshme për te përcaktuar nëse produkti është ne përputhje me te dhënat e projektit.

(c) Mban një sistem te inspektimit te prodhimit që siguron se çdo produkt është ne përputhje me te dhënat e zbatueshme te projektit dhe është ne gjendje te opërojë ne mënyrë te sigurte.

(d) Jep asistencë për mbajtësit e certifikates tip, çertifikatës tip te kufizuar ose miratimit te projektit kur ka te bëjë me veprime te vazhdueshmerise se vlefshmerise ajrore që kane lidhje me produktet, pjesët dhe pajisjet që jane prodhuar.

(e) Vendos dhe mban një sistem te ngjarjeve te brendshme për te mirën e sigurisë, për te mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve te ngjarjeve ne mënyrë që te identifikohen prirjet negative dhe te zgjidhin mangësite si dhe te shkëpusë ngjarjet e raportueshme. Ky sistem përfshin vlerësimin e informacionit te nevojshëm ne lidhje me ngjarjet dhe përhapjen e informacionit që ka te bëjë me te.

(f) 1. I Raporton mbajtësit certifikates tip ose te miratimit te programit te mirembajtjes, te gjitha rastet kur produktet, pjesët ose pajisjet jane hedhur ne treg nga prodhuesi dhe më pas është identifikuar se ato devijojne nga te dhënat e zbatueshme te projektit dhe heton me mbajtësin e çertifikatës tip ose te miratimit te programit te mirembajtjes për te identifikuar ato devijime te cilat mund te cojne ne një gjendje te pasigurte.

2. I raporton DPAC devijimet te cilat mund te cojne ne një gjendje te pasigurte te identifikuar sipas nenparagrafit (1). Raporte te tilla bëhen ne formën dhe mënyrën e përcaktuar nga DPAC sipas 21A.3 (b) (2).

3. Kur prodhuesi vepron edhe si furnizues për një organizatë tjetër prodhuese, i raporton edhe asaj organizatë te gjitha rastet kur i ka kaluar asaj organizatë produkte, pjesë ose pajisje për te cilat ka identifikuar më pas se ka devijime te mundshme nga te dhënat e zbatueshme te mirembajtjes.

21A.130 Deklarata e konformitetit

(a) Secili prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje te prodhuar sipas kësaj Nenpjesë bën një Deklarate Konformiteti, një formular EASA 52 për avion te përfunduar ose Formular EASA 1 për produkte, pjesë apo pajisje te tjera (shih Shtojcën). Kjo deklarate firmoset nga përsone i autorizuar i cili ka një pozicion me përgjegjësi ne organizatën prodhuese.

(b) Deklarata e konformitetit përfshin:

I. Për çdo produkt, pjesë ose pajisje një deklarate se produkti, pjesa ose pajisja është konform te dhënavë te miratuara te projektit dhe është ne gjendje te opërohet ne mënyrë te sigurte.

te mëdha miratohen ne përputhje me 21A.95 ose 21A.97 sipas rastit dhe identifikohen ne mënyrën e duhur.

21A.92. E drejta për t'u përzgjedhur

(a) Vetëm mbajtësi i certifikates mund te aplikojë për miratimin e një ndryshimi te madh ne programin tip sipas kësaj Nenpjesë; te gjithë aplikantet e tjerë për një ndryshim te madh ne programin tip aplikojne ne përputhje me Nenpjesën E.

(b) Çdo person fizik ose juridik mund te aplikojë për një ndryshim te vogël te programit tip sipas kësaj Nenpjesë.

21A.93 Aplikimi

Aplikimi për miratimin e një ndryshimi te programit tip bëhet ne formën dhe mënyrën e përcaktuar nga DPAC dhe përfshin:

(a) Një përshkrim te ndryshimit që identifikon:

1. Te gjitha pjesët e programit tip dhe manualet e miratuara që preken nga ndryshimi; dhe

2. Specifikimet e certifikimit dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore me te cilat duhet te përputhet ndryshimi sipas 21A.101.

(b) Identifikimi i çdo ri-hetimi te nevojshëm për te treguar se produkti i ndryshuar është ne përputhje me specifikimet e zbatueshme te certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore.

21A.95 Ndryshime te vogla

Ndryshimet e vogla te programit tip klasifikohen dhe miratohen:

(a) Nga DPAC; ose

(b) Nga një organizatë e miratuar mirembajtje sipas një procedure për te cilën bihet dakord me DPAC.

21A.97 Ndryshimet e mëdha

(a) Një aplikant për miratimin e një ndryshimi te madh:

1. I paraqet DPAC te dhëna vërtetuese së bashku me te dhëna te tjera përshkruese te nevojshme për tu përfshirë ne programin e mirembajtjes tip.

2. Tregon se produkti i ndryshuar përputhet me specifikimet e zbatueshme te certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, sikurse specifikohet ne 21A.101;

3. Deklaron së ka treguar përputhjen me bazën e zbatueshme te certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore si dhe vë ne dispozicion DPAC bazën mbi te cilën është bërë ky deklaram; dhe

4. Kur aplikanti ka miratimin e një organizatë mirembajtje te përshtatshme, bën deklarate e nenparagrafit (a)(3) ne përputhje me dispozitat e Nenpjesës J;

5. Është ne përputhje me 21A.33 dhe kur është e zbatueshme, me 21A.35.

(b) Miratimi i një ndryshimi te madh ne një programin e mirembajtjes tip kufizohet për ate ose ato konfigurime specifike ne programin tip i cili është ndryshuar.

21A.101 Përcaktimi i specifikimeve te zbatueshme te certifikimit dhe i kërkesave për mbrojtjen mjedisore

(a) Një aplikant për një ndryshim te certifikates tip demonstroi se produkti i ndryshuar është ne përputhje me kodin e vlefshmerise ajrore që është i zbatueshëm për produktin e ndryshuar dhe që është ne fuqi dite e aplikimit për ndryshim, dhe me kërkesat për mbrojtjen mjedisore te përcaktuara ne 21A.18.

21A.134 Aplikimi

Secila procedure për një organizatë prodhuese bëhet prane DPAC ne formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ai autoritet, dhe përfshin një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga 21A.143 dhe kriteret e miratimit të aprovuara për tu lëshuar sipas 21A.151.

21A.135 Dhënia e lejes për miratimin e organizatës prodhuese

Organizatata kanë të drejtën t'i jepet leje për një organizatë prodhuese nga DPAC kur ato tregojnë se përmbushin kërkesat e zbatueshme sipas kësaj Nenpjesë.

21A.139 Sistemi i cilësisë

(a) Organizata prodhuese vërteton se ka vënë ne punë dhe është ne gjendje të ruajë një sistem cilësie. Sistemi i cilësisë dokumentohet. Ky sistem cilësie është i tillë që t'i mundësojë organizatës që të sigurojë se çdo produkt, pjesë ose pajisje e prodhuar nga organizata ose nga partnerët e saj ose të siguruara nga ose të nenkontraktuara ndaj palëve të jashtme, është konform të dhënave të zbatueshme të projektit dhe është ne gjendje për operim të sigurtë dhe kështu ushtron privilegjet e përcaktuara ne 21A.163.

(b) Sistemi i cilësisë përmban:

1. Sikurse është e zbatueshme brenda fushës së miratimit, procedura kontrolli për:

- (i) Lëshimin, miratimin ose ndryshimin e dokumentave
- (ii) Revizionin dhe kontrollin e shitesit dhe nenkontraktuesit.
- (iii) Verifikimin se pjesët, materialet dhe pajisjet që vijnë duke përfshirë edhe artikuj që janë të rinj ose të përdorur nga blerësit e produkteve, janë sikurse specifikohet ne të dhënat e zbatueshme të projektit.
- (iv) Identifikimin dhe ndjekjen
- (v) Proceset e prodhimit.
- (vi) Inspektimi dhe provat duke përfshirë prova fluturimi të prodhimit.
- (vii) Kalibrimi i makinerive, veglave dhe pajisjeve të testimit.
- (viii) Kontroll mospërputhes i objektit.
- (ix) Koordinim për aftesine për të fluturuar me aplikantin për ose mbajtësin e miratimit të mirembajtjes.
- (x) Plotësimi dhe mbajtja e të dhënave.
- (xi) Kompetenca dhe kualifikimet e personelit.
- (xii) Lëshimi i dokumentave të aftesisë për të fluturuar.
- (xiii) Përpunimi, ruajtja dhe paketimi.
- (xiv) Revizione të cilësisë së brendshme që rezultojnë nga veprimet korrigjuese.
- (xv) Puna brenda kushteve të miratimit kur kryhet ne vende të tjera të ndryshme nga ato të miratuara.
- (xvi) Puna e kryer pas përfundimit të produktit por para lëvrimit të tij për ta mbajtur avionin ne gjendje të përdorim të sigurtë.

Procedurat e kontrollit duhet të përfshijnë dispozita specifike për pjesët kritike.

2. Një funksion i pavarur që siguron cilësinë për të monitoruar përputhshmërinë me dhe përshatshmërinë e procedurave të dokumentuara të sistemit të cilësisë. Ky

2. Organizata prodhuese ka përcaktuar një procedurë për të siguruar se të dhënat për aftesine për të fluturuar, zhurmen, kualitetin, cilesine dhe karakteristikat e karburantit dhe emetimin e shkarkimeve përfshihen në mënyrën e duhur në të këto të dhëna të prodhimit.

3. Këto të dhëna mbahen të përditesuara dhe i vihen në dispozicion gjithë personelit që ka nevojë të ketë akses të këto të dhëna për të kryer detyrat e tyre.

(c) përsa i përket drejtuesve dhe stafit:

1. Menaxheri emërohet nga organizata dhe i përgjigjet DPAC. Përgjegjësia e tij ose e saj brenda organizatës është të sigurojë se gjithë procesi i prodhimit kryhet në përputhje me standartet e kërkuara dhe se organizata prodhuese vazhdimisht është në përputhje me të dhënat dhe procedurat e identifikuara në ekspozitë e përmendur në 21A. 143.

2. Një person ose grup personash caktohet nga organizata prodhuese për të siguruar se organizata është në përputhje me kërkesat e kësaj Pjesë dhe identifikohen, së bashku, me gjithë autoritetin e tyre. Ky person / këta persona veprojnë nën autoritetin e drejtpërdrejtë të drejtuesit përgjegjës të cilit iu referuam në nenparagrafin (1). Personat e emëruar janë në gjendje të tregojnë njohuritë e duhura, formimin dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

3. Personelit në të gjitha nivelet i jepet autoriteti i përshatshëm që të mundin të përmbushin përgjegjësitë që u janë caktuar dhe që të ketë koordinim të plote dhe efektiv brenda organizatës prodhuese përsa i përket çështjeve të të dhënave të aftesisë për të fluturuar, zhurmës, kualitetin, cilesine dhe karakteristikat e karburantit dhe emetimit të shkarkimeve.

(d) përsa i përket stafit certifikues, të autorizuar nga organizata prodhuese për të firmosur dokumentat e lëshuara sipas 21A.163 nën sferën e kushteve të miratimit:

1. Njohuritë, formimi profesional (duke përfshirë funksione të tjera në organizatë), dhe përvoja e personelit certifikues janë të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë që u janë caktuar.

2. Organizata prodhuese mban të dhëna për të gjithë personelin certifikues që përfshin hollësi të fushës së punës së tyre dhe të autorizimit të tyre.

3. Personelit certifikues u janë dhënë prova të fushës dhe autorizimit të tyre.

21A.147 Ndryshime të organizatës prodhuese të miratuar

(a) Pas dhënies së miratimit për organizatën prodhuese, secili ndryshim i organizatës së miratuar të prodhimit, i cili është domethënës për të treguar konformitetin ose për aftesine për të fluturuar dhe karakteristikat e zhurmës, kualitetin, cilesine dhe karakteristikat e karburantit dhe emetimit të shkarkimeve të produktit, pjesës ose pajisjes, sidomos ndryshime ndaj sistemit të cilësisë, miratohen nga DPAC. Kërkesa për miratim i paraqitet me shkrim DPAC dhe organizata i vërteton DPAC para realizimit të ndryshimit se do të vazhdojë të veprojë në përputhje me këtë Nenpjesë.

(b) DPAC përcakton kushtet sipas së cilave një organizatë prodhimi e miratuar sipas kësaj Nenpjesë mund të veprojë gjatë këtyre ndryshimeve, përveçse kur DPAC vendos se miratimi duhet të pezullohet.

21A.148 Ndryshimi i vendndodhjes

LETTER OF AGREEMENT

Competent authority of
a Member State of
the European Union or EASA

NAME OF THE APPLICANT:
TRADE NAME (if different):
FULL ADDRESS OF THE APPLICANT:

Date: Day, Month, Year:
Reference: [NAA-0/XXX]

Subject: PRODUCTION WITHOUT POA, LETTER OF AGREEMENT

Dear Sirs,

Your production inspection system has been evaluated and found to be in compliance with Part 21, Section A, Subpart F.

Therefore, subject to the conditions specified below, we agree that showing of conformity of products, parts and appliances mentioned below may be done under Part 21, Section A, Subpart F.

No of Units	P/N	S/N
-------------	-----	-----

AIRCRAFT

PARTS

The following conditions are applicable to this agreement:

1. It is valid whilst [Company Name] remains in compliance with Part 21, Section A, Subpart F.
2. It requires compliance with the procedures specified in [Company Name] Manual Release date:
3. It terminates on
4. The Statement of Conformity issued by [Company Name] under the provisions of 21A.130 shall be validated by the issuing authority of this letter of agreement in accordance with the procedure of the above referenced Manual.
5. [Company Name] shall notify the issuing authority of this letter of agreement immediately of any changes to the production inspection system that may affect the inspection, conformity, or airworthiness of the products and parts listed in this letter.

Date and Signature

Competent authority of a Member State of the European Union or EASA	Terms of Approval	TA: NAA.GXXXX
This document is part of Production Organisation Approval Number NAA.GXXXX issued to		
Company name		
Section 1. SCOPE OF WORK:		
PRODUCTION OF	PRODUCTS/CATEGORIES	
For details and limitations refer to the Production Organisation Exposition, Section xxx		
Section 2. LOCATIONS:		
Section 3. PRIVILEGES:		
The Production Organisation is entitled to exercise, within its Terms of Approval and in accordance with the procedures of its Production Organisation Exposition, the privileges set forth in 21A.163. Subject to the following:		
Prior to approval of the design of the product an EASA Form 1 may be issued only for conformity purposes.		
A Statement of Conformity may not be issued for a non-approved aircraft.		
Maintenance may be performed, until compliance with maintenance regulations is required, in accordance with the Production Organisation Exposition Section xxx.		
Date of origin of issue	Date of this issue	Signed: For the competent authority of EASA

CERTIFICATE OF RELEASE TO SERVICE

[APPROVED PRODUCTION ORGANISATION NAME]

Production organisation approval Reference:

Certificate of release to service in accordance with 21A.163(d).

Aircraft: Type: Constructor No./Registration:

has been maintained as specified in Work Order:

Brief description of work performed:

Certifies that the work specified was carried out in accordance with 21A.163(d) and in respect to that work the aircraft is considered ready for release to service and therefore is in a condition for safe operation.

Certifying Staff name:

(signature):

Location: -

Date:, day, month, year.

CERTIFICATE OF AIRWORTHINESS

<p>1. Nationality and registration marks</p>	<p>2. Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft</p>	<p>3. Aircraft serial number</p>
<p>4. Categories</p>		<p>5. Member state of registry/Issuing Authority</p>
<p>5. This Certificate of Airworthiness is issued pursuant to the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944 and Regulation (EC) No 1702/2002, Article 5(3)(c) in respect of the abovementioned aircraft which is considered to be airworthy when maintained and operated in accordance with the foregoing and the pertinent operating limitations.</p>		
<p>Date of issue: _____ Signature: _____</p>		
<p>Signature/Block: _____</p>		
<p>6. This Certificate of Airworthiness is valid unless revoked by the competent authority of the Member State of registry. A current Airworthiness Review Certificate shall be attached to this Certificate.</p>		

Competent authority (DGO)

PERMIT TO FLY

2.	
3. Competent authority of a Member State of registry granted by virtue of Regulation (EU) No 1392/2002 hereby permits noted aircraft to fly within the Member State under conditions listed below. This permit is also valid for flight to and within other States provided separate approval is obtained from the competent authorities of such States.	1. Nationality and registration marks
2. Aircraft identification code	3. Serial number
4. The permit covers	
5. Conditions/Remarks	
6. Place and date of issue	7. Signature of the competent authority representative

APPROVAL SCHEDULE

Organizational name: [COMPANY NAME] MAINTENANCE ORGANISATION

Reference: M.S.001

CLASS	RANGES	LIMITATION	BASE	DEF
AIRCRAFT	A1: aircraft less than 5,700 kg	Airbus A310-200 Series	X	X
	A2: aircraft less than 5,700 kg and below	Boeing 737-400 Series	X	
ENGINES	B1: Turbine	PT6A Series		
COMPONENTS OTHER THAN COMPOSITE FUELINGS OR APUs	C1: Air Cond & Heat	Airbus A310-200		
	C2: Auto Flight	Suony		
	C3: Electrical Power	Airbus A310-200 & B737-400		
	C4: Equipment	Airbus & Boeing Emergency		
	C5: Engine APU	PT6A Fuel Control		
	C6: Propellers	Fixed pitch and D11C-6		
SPECIAL SERVICES	D1: Non-Destructive Inspection	All Types		

This approval schedule is limited to those products and activities specified in the scope of approval section contained in Part-145 approved maintenance organisation exposition.

Reference:

Date of issue:

Signed:

For the competent authority

1. Approving Competent Authority / Country 2.

3. Form Title / Number

AUTHORISED RELEASE CERTIFICATE

EASA FORM 1

4. Approved Organisation Name and Address

5. Work order/Contract number

6. Item	7. Description	8. Part No.	9. Eligibility*	10. Qty.	11. Serial/Part No.	12. Status/Work

13. Remarks

14. Certificate that the items identified above were manufactured in conformity to approved design data and are in condition for safe operation from approved design data specified in block 13.

19. Part 145 A.63 Release to Service Other regulation specified in block 13

Confirm that unless otherwise specified in block 13, the work identified in blocks 12 and described in block 13, was accomplished in accordance with Part 145 and in support to that work the items are prepared ready for release to service.

15. Authorised Signature

16. Approval/Authorisation Number

20. Authorised Signature

21. Certificate/Approval No.

17. Name

18. Date (dd/mm/yy)

22. Name

23. Date (dd/mm/yy)

EASA Form 1 - Issue 1

* Eligible must comply with applicable technical data

2. vlerësimin e dokumentacionit të marre me aplikimin;
3. inspektimin e avionit.

21B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmes

DPAC, si të jetë e zbatueshme, lëshon ose amendon certifikatat e zhurmes (Formulari EASA 45, shiko Shtojcën) pa vonesa të mëtejshme kur konkludon se kërkesat e zbatueshme të Seksionit A, Nenpjesa I janë plotësuar.

21B.430 Pezullimi dhe shfuqizimi i certifikatës të zhurmes

(a) Kur ka prova se disa nga kushtet e specifikuar në 21A.211(a) nuk janë plotësuar, DPAC pezullon ose shfuqizon një certifikatë zhurme.

(b) Me lëshimin e njoftimit të pezullimit dhe shfuqizimit të një certifikatë të zhurmes, DPAC paraqet arsyet për pezullimin dhe shfuqizimin dhe informon mbajtësin e certifikatës mbi të drejtën e tij për të apeluar.

21B.445 Mbajtja e të dhënave

(a) DPAC krijon një sistem të ruajtjes së të dhënave me kriteret minimale të ruajtjes që lejojnë ndjekje të mjaftueshme të procesit për të lëshuar, mirëmbajtur, amenduar, pezulluar ose shfuqizuar çdo certifikatë individuale të zhurmes.

(b) Të dhënat pëmbajne të pakten:

1. dokumentet e paraqitura nga aplikanti,
2. dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit, në të cilat pasqyrohen aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.420(b)
3. një kopje të certifikatës duke përfshirë amendimet.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhë minimale të ruajtjes prej 6 vjetësh pas largimit nga ai regjistër kombëtar.

NENPJESA J

MIRATIMI I ORGANIZATËS SE MIREMBAJTJES

Zbatohen procedura administrative të propozuara nga DPAC në përputhje me rregullat e nxjerra nga Agjensia.

NENPJESA K

PJESËT DHE PAJISJET

Zbatohen procedura administrative të propozuara nga DPAC në përputhje me rregullat e nxjerra nga Agjensia.

NENPJESA L

(b) Kufizimet, pezullimet ose shfuqizimet e miratimit të organizatës prodhuese i komunikohen me shkrim mbajtësit të miratimit të organizatës prodhuese. DPAC konstaton arsyet për pezullimin ose revokimin dhe informon mbajtësin e miratimit të organizatës prodhuese mbi të drejtën e tij për apelim.

(c) Kur miratimi i organizatës prodhuese është pezulluar, ai mund të rikthehet vetëm pasi të jetë rivendosur përputhshmeria me Seksionin A, Nenpjesa G.

21B.260 Mbajtja e të dhënave

(a) DPAC krijon një sistem të mbajtjes së të dhënave që lejon ndjekjen e përshtatshme të procesit të lëshimit, mbajtjes, amendimit, pezullimit ose shfuqizimit të çdo miratimi të organizatave prodhuese.

(b) Të dhënat përmbajne të pakten:

1. dokumentat e siguruar nga aplikanti ose mbajtësi i çertifikatës së miratimit të organizatës prodhuese,

2. dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit, në të cilat janë konstatuar aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.220, duke përfshirë konkluzionet e arritura në përputhje me 21B.225.

3. programin e mbikqyrjes së vazhdueshme, duke përfshirë të dhënat e investigimeve të kryera

4. çertifikatën e miratimit të organizatës prodhuese, duke përfshirë ndryshimet

5. proces - verbalet e takimeve me mbajtësin e miratimit të organizatës prodhuese.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhë minimale të ruajtjes prej 6 vjetësh.

NENPJESA H

ÇERTIFIKATAT E VLEFSHMERISE AJRORE

21B.320 Investigimi

(a) DPAC kryen aktivitete investiguese të mjaftueshme për një aplikant për, ose mbajtës të çertifikatës së Vlefshmerise Ajrore për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, amendimin, pezullimin ose shfuqizimin e çertifikatës ose të lejes.

(b) DPAC përgatit procedurat e vlerësimit që përfshjne të pakten elementet e mëposhtem:

1. vlerësimin e të drejtës për t'u përzgjedhur të aplikantit;

2. vlerësimin e të drejtës për t'u përzgjedhur të aplikimit;

3. klasifikimin e çertifikatave të aftësisë për të fluturuar;

4. vlerësimin e dokumentacionit të marre me aplikimin;

5. inspektimin e avionit.

6. përcaktimin e kushteve të nevojshme, kufizimeve ose limiteve të certifikave të vlefshmerise ajrore

21B.325 Lëshimi i çertifikatave të Vlefshmerise Ajrore

NENPJESA G

MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE

21B.220 Investigimi

(a) DPAC cakton një grup te miratimit te organizatës prodhuese për çdo aplikant, ose mbajtes te një miratimi te organizatës prodhuese te kryeje çdo detyre përkatëse ne lidhje me kete miratim te organizatës prodhuese, i cili përbëhet nga një drejtues grupi për te menaxhuar dhe drejtuar grupin e miratimit dhe nëse kerkohet, një ose me shume Anëtare grupi. Drejtuesi i grupit i raporton menaxherit përgjegjes për aktivitetin sic përcaktohet ne 21B.25(b)(2).

(b) DPAC kryen aktivitete te mjaftueshme investiguese për një aplikant ose mbajtes te një miratimi te organizatës prodhuese për te justifikuar rekomandimet për lëshimin, mbajtjen, amendimin, pezullimin ose shfuqizimin e miratimit.

(c) DPAC përgatit procedurat për investigimin për miratimin e organizatës prodhuese si pjesë e procedurave te dokumentuara qe përfshijne te pakten elementet e meposhtem:

1. vleresimin e aplikimeve te marra;
2. përcaktimin e grupit te miratimit te organizatës prodhuese;
3. përgatitjet dhe planifikimi i investigimit;
4. vleresim te dokumentacionit (ekspozeja e organizatës prodhuese, procedurat, etj.);
5. auditimin;
6. ndjekja e veprimeve korigjuese;
7. rekomandimet për lëshimin, amendimin, pezullimin ose shfuqizimin e miratimit te organizatës prodhuese;
8. mbikqyrje e vazhdueshme.

21B.225 Njoftimi i konkluzioneve

(a) Kur gjenden prova objektive qe tregojne mospërputhshmeri te mbajtësit miratimit te organizatës prodhuese me kerkesat e zbatueshme te kesaj Pjesë, ky konkluzion klasifikohet ne përputhje me 21A.158(a) dhe:

1. Konkluzionet e nivelit te parë i njoftohen menjëherë mbajtësit te miratimit te organizatës prodhuese dhe konfirmohen me shkrim brënda tre dite pune pas vendimit.
2. Konkluzionet e nivelit te dytë i konfirmohen me shkrim mbajtësit te miratimit te organizatës prodhuese brënda 14 dite pune pas vendimit.

(b) DPAC i identifikon mbajtësit te miratimit te organizatës prodhuese çdo përfundim te nivelit te tretë, sic përcaktohet ne 21A.158(b), përmes mjetëve te përshtatshme, si te jetë e përshtatshme për te.

21B.230 Lëshimi i certifikates

(a) Kur Autoriteti Kompetent konkludon se prodhuesi përmbush kërkesat e zbatueshme të Seksionit A, Nenpjesa F, ai, pa vonesa të pajustificueshme, lëshon një leter marrëveshje për të treguar konformitetin e produkteve, pjesëve ose pajisjeve individuale (Formulari EASA 65, shiko Shtojcën).

(b) Letër marrëveshje përmban qëllimin e marrëveshjes, datën e përfundimit dhe, kur është e zbatueshme, kufizimet e përshtatshme lidhur me autorizimin.

(c) Kohezgjatja e leter marrëveshjes nuk është më shumë se një vit.

21B.135 Mbajtja e leter marrëveshjes

DPAC mban leter marrëveshjen për sa kohë që:

(a) prodhuesi përdor sic duhet Formularin EASA 52 (shiko Shtojcën) si një Deklaratë të Konformitetit për të gjithë avionin, dhe Formularin EASA 1 (shiko Shtojcën) për produktet që nuk janë avioni i plote, pjesët dhe pajisjet; dhe

(b) Inspektimet e kryera nga DPAC përpara vlefesimit të formularit EASA 52 (shiko Shtojcën) ose formularit EASA 1 (shiko Shtojcën), si për 21A.130(c) dhe nuk japin ndonjë konkluzion mospërputhjeje ndaj kërkesave ose procedurave që përfshihen në manualin e siguruar nga prodhuesi, ose ndaj konformitetit të produkteve, pjesëve ose pajisjeve përkatëse. Keto inspektime kontrollojnë të pakten që:

1. Marrëveshja mbulon produktin, pjesën ose pajisjen që vleftehet dhe mbetet e vlefshme;

2. Manuali i përshkruar në 21A.125(b) dhe statusi i tij i ndryshuar i përmendur në leter marrëveshjen e lëshuar si dokumenti baze i punës nga prodhuesi. Përndryshe, inspektimi nuk vazhdon dhe për rrjedhojë certifikatat e lëshimit nuk do të vleftehen;

3. Prodhimi është kryer sipas kushteve të përshkruara në leter marrëveshjen dhe është realizuar në mënyrë të kënaqshme;

4. Inspektimet dhe testet (përfshirë testet e fluturimit, nëse është e përshtatshme) si për 21A.130(b)(2) dhe/ose (b)(3), janë kryer sipas kushteve të përshkruara në leter marrëveshjen dhe janë realizuar në mënyrë të kënaqshme;

5. Inspektimet e DPAC të përshkruara ose trajtuara në leter marrëveshjen janë kryer dhe janë gjetur të pranueshme;

6. Deklarata e Konformitetit përputhet me 21A.130, dhe informacioni i siguruar nga ajo nuk e pengon vleftesimin e saj; dhe

(c) Nuk është arritur ndonjë datë përfundimi për leter marrëveshjen.

21B.140 Amendimi i një Akt - marrëveshjeje

(a) DPAC investigon, si të jetë e përshtatshme, në përputhje me 21B.120 çdo amendim të akt marrëveshjes.

(b) Kur një DPAC konkludon se kërkesat e Seksionit A, Nenpjesa F vazhdojnë të përmbushen amendon akt marrëveshjen përkatësisht.

21B.143 Njoftimi i konkluzioneve

21B.30 Proçedurat e dokumentuara

- (a) DPAC përcakton proçedurat e dokumentura për te përshkruar organizatën e tij, mjetët dhe metodat për te përmbushur kerkesat e kesaj Pjesë. Proçedurat mbahen te përditesuara dhe sherbejne si dokumente baze pune brënda atij autoriteti për te gjitha aktivitetet përkatëse.
- (b) Një kopje e procedurave dhe amendimet e tyre i vihet ne dispozicion DPAC.

21B.35 Ndryshimet ne organizatë dhe proçedurat

- (a) DPAC i propozon Ministrit te Transportit per çdo ndryshim te rendesishem per organizatën dhe proçedurat e dokumentuara.
- (b) DPAC propozon përditesimin ne kohë proçedurat e tij te dokumentura lidhur me çdo ndryshim ne rregulloret për te siguruar zbatimin efektiv.

21B.40 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- a) Kur ndërmjet DPAC dhe autoriteteve kompetente te Shtete Anëtare ka një mosmarrëveshje që nuk mund te zgjidhet, sikurse përcaktohet ne 21B.25(b)(2), DPAC mund te kerkoje rekomandime nga Agjensia për çështjen ne fjalë.

21B.45 Raportimi/koordinimi

- (a) DPAC siguron koordinimin sikurse është e zbatueshme, me ekipet e tjera përkatëse te çertifikimit, investigimit, miratimit ose autorizimit te atij autoriteti, Shteteve te tjera Anëtare te BE dhe Agjensisë për te siguruar shkembim efikas te informacionit qe lidhet me sigurine e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve.
- (b) DPAC mund te kerkoje asistencë nga Agjensia për çdo veshtiresi ne zbatimin e kesaj Pjesë.

21B.55 Mbajtja e te dhënave

DPAC mban ose ruan akses ne te dhënat e përshtatshme lidhur me certifikimet, miratimet dhe autorizimet qe ka lëshuar ne përputhje me rregulloret kombetare respektive, dhe për te cilat përgjegjesia i transferohet Agjensisë, për aq kohe sa keto te dhëna nuk i jane transferuar Agjensisë.

NENPJESA B

ÇERTIFIKATAT TIP DHE ÇERTIFIKATAT TIP TE KUFIZUARA

Zbatohen procedura administrative te përcaktuara nga DPAC sipas rekomandimeve te EASA.

NENPJESA C

Ajrore, qe trajtojne riparimin ose forma te tjera te mirëmbajtjes se rende, mund te vonohen deri sa produkti te jetë vene ne sherbim, por duhet te jetë i disponueshem përpara se ndonjë nga produktet te arrije moshen ose oret/ciklet e fluturimit përkatës.

(b) Nëse rifreskimet e ketyre ndryshimeve te udhëzimeve për vazhdueshmerine e Vlefshmerise Ajrore lëshohen nga mbajtësi i miratimit te programit te mirembajtjes, pasi riparimi është miratuar me pare, ato do t'i sigurohen dhe jepen çdo operatori dhe sipas kërkesave do te vihen ne dispozicion te çdo përsone tjetër që duhet te përmbushë ndonjë nga kushtet e atyre ndryshimeve te udhëzimeve. Një program qe tregon sesi shpërndahen rifreskimet e ketyre ndryshimeve te udhëzimeve për vazhdueshmerine e Vlefshmerise Ajrore i dorëzohet DPAC.

21A.451 Detyrimet dhe shenimi MEP (Miratimi European i Pjeses)

(a) Secili mbajtes i një miratimi te programit te një riparimi te madh:

1. merr përsipër detyrimet:

(i) e përcaktuara ne 21A.3, 21A.3B, 21A.4, 21A.439, 21A.441, 21A.443, 21A.447 dhe 21A.449;

(ii) e nenkuptuara ne bashkëpunim me mbajtësin e çertifikatës tip ose çertifikatës tip shtese ose te dyja, sipas 21A.433 (b), si te jetë e përshtatshme.

2. specifikon shenimin, duke përfshire geramat MEP ("Miratimi Evropian i Pjesës") ne përputhje me 21A.804(a).

(b) Me përjashtim te mbajtësit te çertifikatës tip për te cilin aplikohet 21A.44, mbajtësi i një miratimi te programit riparues te vogel:

1. merr përsipër detyrimet e përcaktuara ne 21A.4, 21A.447 dhe 21A.449; dhe

2. specifikon shenimin, duke përfshire geramat MEP, ne përputhje me 21A.804(a).

NENPJESA N

=====

E PAZBATUESHME

NENPJESA O

=====

E PAZBATUESHME

NENPJESA P

=====

E PAZBATUESHME

1. Tregon përputhshmeri me bazen e çertifikatës tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, të përfshira nëpërmjet referimit në çertifikatën tip ose çertifikatën tip shtesë, të zbatueshme, ose me ato në fuqi në ditën e aplikimit (për miratimin e procesit të mirembajtjes), si dhe me amendamente të atyre specifikimeve të çertifikimit ose kushteve të vecanta të cilat DPAC i konsideron të nevojshme për të përcaktuar një nivel sigurie të barabartë me atë të përcaktuar nga baza e çertifikimit tip të përfshirë nëpërmjet referencës në çertifikatën tip ose në çertifikatën tip shtesë.

2. Paraqet të gjithë të dhënat e nevojshme mbështetëse, kur kërkohen nga DPAC.

3. Deklaron përputhshmeri me specifikimet e çertifikatës dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të nenparagrafit (a)(1).

(b) kur aplikanti nuk është mbajtes i çertifikatës tip ose çertifikatës tip shtese, sikurse është praktika, aplikanti mund të përmbushë kërkesat e paragrafit (a) përmes përdorimit të burimeve të tij ose përmes një marrëveshjeje me mbajtësin e një çertifikatë tip ose çertifikatë tip shtese sikurse është e zbatueshme.

21A.435 Klasifikimi i riparimeve

(a) Riparimi mund të jetë “i madh” ose “i vogel”. Klasifikimi bëhet në përputhje me kriteret e 21A.91 për një ndryshim në projektin tip.

(b) Riparimi klasifikohet “i madh” ose “i vogel” sipas paragrafit (a) ose:

1. Nga DPAC, ose

2. Nga një organizatë mirembajtjeje e miratuar ashtu si duhet sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me DPAC.

21A.437 Dhënia e miratimit të procesit të mirembajtjes

Kur është deklaruar dhe është treguar se procesi mirembajtjes përmbush specifikimet certifikuese të zbatueshme dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të 21A.433(a)(1), ai miratohet nga:

(a) nga DPAC, ose

(b) nga një organizatë e aprovuar si duhet që është gjithashtu mbajtesë e çertifikatës tip ose çertifikatës tip shtese, sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me DPAC, ose

(c) vetëm për riparimet e vogla, nga një organizatë mirembajtjeje e miratuar si duhet sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me DPAC.

21A.439 Prodhimi i pjesëve për riparim

Pjesët dhe pajisjet që do të përdoren për riparim prodhohen në përputhje me të dhënat prodhuese të bazuara në të gjitha të dhënat e nevojshme si jepen nga mbajtësi i miratimit të mirembajtjes:

(a) Sipas Nenpjesës F, ose

(b) Nga një organizatë e miratuar si duhet në përputhje me Nenpjesën G, ose

(c) Nga një organizatë mirembajtjeje e aprovuar si duhet.

21A.441 Repairimi i dëmeve strukturale

- (a) Mban manualin ne përputhje me sistemin e garancise se mirembajtjes;
- (b) Siguron qe ky manual lëshohet si një dokument baze pune brënda organizatës;
- (c) Përcakton qe projekti i produktit, ose ndryshimet ose riparimet e tij, sipas rastit, përputhen me kerkesar e zbatueshme dhe nuk kane tipar te pasigurte;
- (d) Me përjashtim te ndryshimeve te vogla ose riparimeve te miratuara sipas privilegjit te 21A.263, t'i siguroje DPAC deklarata dhe dokumentacione shoqeruese qe konfirmojne përputhje me paragrafin (c);
- (e) I siguron DPAC informacionin ose udhëzimet qe lidhen me veprimet e kërkuara sipas 21A.3B.

NENPJESA K

=====

PJESËT DHE PAJISJET

21A.301 Qëllimi

Kjo Nënpjesë përcakton proceduren ne lidhje me miratimin e pjesëve dhe pajisjeve.

21A.303 Përputhshmeria me kërkesat e zbatueshme

Përputhshmeria e pjesëve dhe pajisjeve për t'u instaluar ne një produkt te mbuluar nga çertifikata tip tregohet:

- (a) ne lidhje me procedurat e çertifikatës tip te Nënpjesës B, D ose E për produktin ne te cilin do te instalohet; ose
- (b) kur është e zbatueshme, sipas procedurave autorizuese ETSO te Nënpjesës O; ose
- (c) Ne rast te pjesëve standard, ne përputhje me Standartet e njohura zyrtarisht.

21A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve

Ne te gjitha rastet kur miratimi i një pjesë ose pajisjeje kërkohet qartesisht nga ligjet e Komunitetit ose masat e DPAC, pjesa ose pajisja përputhet me ETSO e zbatueshme ose me specifikimet e njohura si ekuivalente nga DPAC ne ate rast te veçante.

21A.307 Lëshimi i pjesëve dhe pajisjeve për instalim

Asnjë pjesë ose pajisje (përvec pjesëve standard) nuk është e pranueshme për instalim ne një produkt te çertifikuar tip përvecse kur:

- (a) shoqerohet me një çertifikatë te lëshimit te autorizuar (Formulari EASA 1), qe certifikon vlefshmerine ajrore; dhe
- (b) është shenuar ne përputhje me Nënpjesën Q.

NENPJESA L

21A.253 Ndryshimet e kushteve te miratimit

Çdo ndryshim ne kushtet e miratimit aprovohet nga Agjensia. Një aplikim për një ndryshim ne termat e aprovimit bëhet ne formën dhe mënyrën e përcaktuar nga DPAC. Organizata e mirembajtjes te përputhet me kërkesat e zbatueshme për kete Nenpjesë.

21A.257 Investigimet

(a) organizata e mirembajtjes kryen veprimet e nevojshme për te lejuar Agjencine te beje çdo investigim, duke përfshire investigimet e partnereve dhe nenkontraktoreve, te nevojshëm për te përcaktuar përputhshmerine dhe përputhshmeri e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme te kësaj Nenpjesë.

(b) Organizata e mirembajtjes lejon DPAC te rishikojë çdo raport dhe te beje çdo inspektim dhe te kryeje ose te jetë e pranishme ne çdo fluturim dhe prove ne toke, te nevojshme për te kontrolluar vlefshmërine e deklaratave te përputhshmerise te dorëzuara nga aplikanti sipas 21A.239(b).

21A.258 Konkluzionet

(a) kur gjenden prova objektive qe tregojne mos përputhshmeri te mbajtësit te miratimit te organizatës mirembajtese me kërkesat e zbatueshme te kësaj Pjesë, konkluzionet klasifikohen si vijon:

1. Konkluzione te nivelit te parë jane çdo mospërputhje me këte Pjesë që mund te çojë ne mospërputhje te pakontrolluara me te dhënat e zbatueshme te mirembajtjes te cilat mund te prekin sigurine e avionit.

2. Konkluzione te nivelit te dytë jane çdo mospërputhje me këte Pjesë që nuk klasifikohen si niveli i parë.

(b) Konkluzione te nivelit te tretë jane çdo element ku, nepërmjet provave objektive, është identifikuar se ka probleme që mund te çojne ne mospërputhje sipas paragrafit (a).

(c) Pasi merret njoftimi për konkluzionet sipas procedurave te zbatueshme administrative te vendosura nga DPAC,

1. Ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te parë, mbajtësi i miratimit te organizatës se mirembajtjes ndërmer veprime korrigjuese ne përputhje me kërkesat e DPAC brenda një periudhe prej jo më shumë se 21 dite pune pas marrjes së konfirmimit me shkrim te konkluzioneve;

2. Ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te dytë, periudha e veprimeve korrigjuese e dhëne nga DPAC do jetë e përshtatshme me natyrën e konkluzioneve por ne çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashte muaj. Ne disa rrethana dhe ne varësi te konkluzioneve, DPAC mund ta zgjasë periudhën gjashte mujore ne një plan te kënaqshëm veprimi te masave korrigjuese për te cilin bihet dakord nga DPAC.

3. Konkluzionet e nivelit te tretë nuk kërkojne që te ndërmerren veprime te menjëherëshme nga mbajtësi i miratimit te organizatës mirembajtese.

(d) ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te parë ose te dytë, miratimi i organizatës mirembajtese mund te jetë subjekt i një pezullimi ose shfuqizimi te pjesshëm ose te plote sipas procedurave te zbatueshme administrative te përcaktuara nga DPAC.

(b) për miratimin e ndryshimeve të vogla ose riparimeve të vogla mirembajtëse, kur kërkohet për qëllimin e marrjes së privilegjeve sipas 21A.263.

21A.234 Aplikimi

Çdo aplikim për miratim të organizatave mirembajtëse bëhet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga DPAC dhe përfshin një përmbledhje të informacionit të kërkuar në 21A.243, dhe kushteve të miratimit që kërkohet të lëshohet sipas 21A.251.

21A.235 Lëshimi i miratimit të organizatës mirembajtëse

Një organizatë ka të drejtën të marrë miratimin si organizatë mirembajtëse të dhënë nga DPAC kur ajo të ketë treguar përputhshmeri me kërkesat e zbatueshme sipas kësaj Nenpjesë.

21A.239 Sistemi i Garancise Mirembajtëse

(a) Organizata mirembajtëse tregon se ka ngritur dhe është në gjendje të mirëmbaje një sistem të garancise mirembajtëse për kontrollin dhe supërvizionin e mirembajtjes, dhe të ndryshimeve, pjesëve dhe pajisjeve të mbuluara nga aplikimi. Ky sistem i garancise mirembajtje duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë organizatës:

1. të sigurojë që mirembajtja e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve ose ndryshimi mirembajtës i tyre, përputhen me çertifikatën tip baze të zbatueshme dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore; dhe

2. të sigurojë që përgjegjësia e saj përmbushen si duhet në përputhje me:

(i) dispozitat e përshtatshme të kësaj Pjesë; dhe

(ii) kushtet e miratimit të lëshuar sipas 21A.251.

3. të monitorojë në mënyrë të pavarur përputhshmerinë me dhe përshtatshmerinë e procedurave të dokumentuara të sistemit. Ky monitorim përfshin një sistem reagimi për një person ose një grup personash që kanë përgjegjësinë për të siguruar veprime korrigjuese.

(b) Sistemi i garancise së mirembajtjes përfshin një funksion kontrollues të pavarur të demonstrimeve të përputhshmerisë mbi bazën e të cilit organizata i dorëzon DPAC deklaratatë të përputhshmerisë dhe dokumenta që kanë të bëjnë me to.

(c) Organizata e mirembajtjes specifikon mënyrën në të cilën sistemi i garancise së mirembajtjes konsideron pranueshmerinë e pjesëve ose pajisjeve ose detyrave të kryera nga partnerë ose nenkontraktore sipas metodave të cilat i nënshtrohen procedurave me shkrim.

21A.243 Të dhëna

(a) Organizata e mirembajtjes pajis DPAC me një manual i cili përshkruan drejtpërdrejt ose përmes referencave, organizatën, procedurat përkatëse dhe produktet ose ndryshimet e produkteve që do të mirembahen.

(b) kur ndonjë pjesë ose pajisje ose ndonjë ndryshim i produkteve projektohet nga organizata ose nenkontraktori partner, manual që përfshin një deklaratë se si organizata mirembajtjes është në gjendje të japë, për të gjitha pjesët dhe pajisjet,

NENPJESA I

=====

ÇERTIFIKATAT E ZHURMES

21A.201 Qëllimi

Kjo Nenpjesë përcakton procedurën e lëshimit të certifikatave të zhurmes.

21A.203 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik në emer të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion në Shqipëri, ose përfaqësuesi i tij, mund të aplikojë për një certifikatë të zhurmes për atë avion sipas kesaj Nenpjesë

21A.204 Aplikimi

(a) bazuar në 21A.172, një aplikim për certifikatë zhurme bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga DPAC.

(b) Secili aplikim përfshin:

1. në lidhje me një avion të ri:

(i) një deklaratë konformiteti:

- të lëshuar sipas 21A.163(b), ose

- të lëshuar sipas 21A.130 dhe vlefësuar nga DPAC

- ose, për një avion të importuar, një deklaratë të nënshkruar nga autoriteti eksportues që avioni përputhet me një mirembajtje të miratuar nga DPAC, dhe

(ii) Informacioni për zhurmen përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme për zhurmen. Ky informacion përfshihet në manualin e fluturimit, kur një manual fluturimi kërket nga kodi i zbatueshem i vlefshmerise ajrore për atë avion në vecanti.

2. në lidhje me një avion të përdorur:

(i) Informacioni për zhurmen përcaktuar në përputhje me kërkesat në zbatim për zhurmen. Ky informacion përfshihet në manualin e fluturimit, kur një i tillë kërket nga kodi i zbatueshem i vlefshmerise ajrore për atë avion në vecanti, dhe

(ii) Te dhënat historike për të përcaktuar prodhimin, modifikimin dhe standartin e mirembajtjes së avionit.

(c) Përvetse kur bihet dakord ndryshe, deklaratat e përmendur në nenparagrafet (b)(1) përdoret jo më shumë se 60 ditë përpara paraqitjes së avionit tek DPAC.

21A.205 Lëshimi i certifikatave të zhurmes

DPAC lëshon një certifikatë të zhurmes me paraqitjen e dokumentave të kërkuara sipas 21A.204(b).

21A.179 Transferueshmëria dhe rilëshimi mes Shqiperise dhe Shteteve Anëtare te BE

(a) Kur pronësia e një avioni ka ndryshuar:

1. nëse mbetet ne te njëjtin regjister, çertifikata e vlefshmerise ajrore, ose çertifikata e kufizuar e vlefshmerise ajrore ne përputhje vetëm me një tip çertifikatë te kufizuar, transferohet se bashku me avionin;

2. nëse avioni është i regjistruar ne një Shtet tjetër Anëtar, çertifikata e vlefshmerise ajrore, ose çertifikata e kufizuar e vlefshmerise ajrore ne përputhje vetëm me një tip lëshohet,

(i) me paraqitjen e çertifikatës se meparshme te vlefshmerise ajrore dhe te një çertifikatë te vlefshme te rishikimit te vlefshmerise ajrore te lëshuar sipas Pjesës M, dhe

(ii) kur plotesohet 21A.175.

(b) Kur pronësia e një avioni ka ndryshuar dhe avioni ka:

1. një çertifikatë te kufizuar te vlefshmerise ajrore qe nuk përputhet me çertifikatën tip te kufizuar, ose

2. një leje për te fluturuar,

Çertifikata te tilla te vlefshmerise ajrore transferohen se bashku me avionin me kusht qe avioni te mbetet ne te njëjtin regjister ose lëshohet vetëm me marreveshje formale te autoritetit kompetent te Shtetit Anëtar te regjistrit ne te cilin transferohet.

21A.180 Inspektimet

Mbajtësi i çertifikatës se vlefshmerise ajrore siguron akses ne avionin për te cilin ajo çertifikatë e vlefshmerise ajrore është lëshuar me kerkese te DPAC.

21A.181 Kohezgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmerise ajrore

(a) një çertifikatë e vlefshmerise ajrore lëshohet për një kohezgjatje te pakufizuar. Ajo mbetet e vlefshme kur:

1. përputhet me projektin tip te zbatueshëm dhe kerkesat e vazhdueshme te vlefshmerise ajrore; dhe

2. avioni mbetet ne te njëjtin regjister; dhe

3. çertifikata tip ose çertifikata tip e kufizuar sipas se ciles është lëshuar nuk është shfuqizuar më parë sipas 21A.51.

4. kur çertifikata nuk dorëzohet ose shfuqizohet sipas 21B.330.

(b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, çertifikata i kthehet DPAC.

21A.182 Identifikimi i Avionit

Çdo aplikant për çertifikatë te vlefshmerise për te fluturuar sipas kesaj Nenpjesë demonstroi se avioni i tij identifikohet ne përputhje me Nenpjesën Q.

21A.183 Lëshimi i çertifikatave te vlefshmerise për te fluturuar

DPAC lëshon një çertifikatë te vlefshmerise për te fluturuar për:

1. avion te ri:

NENPJESA H

=====

ÇERTIFIKATAT E VLEFSHMERISE AJRORE

21A.171 Qëllimi

Kjo nenpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave të vlefshmerise ajrore

21A.172 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik në emer të të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion në Shqipëri, ose përfaqësuesi i tij, do të pranohet si një aplikant për një certifikatë të vlefshmerise ajrore për atë avion sipas kësaj Nenpjesë.

21A.173 Klasifikimi

Çertifikatat e vlefshmerise ajrore klasifikohen si vijon:

(a) Çertifikatat e vlefshmerise ajrore lëshohen për avione që përputhen me një tip certifikatë që është lëshuar në përputhje me këtë Pjesë.

(b) Çertifikatat e kufizuara të vlefshmerise ajrore lëshohen për avione:

1. të cilët përputhen me një tip certifikatë të kufizuar që është lëshuar në përputhje me këtë pjesë; ose

2. për të cilët i është treguar DPAC se përmbushin specifikimet e vecanta të certifikimit duke pasur siguri të mjaftueshme.

(c) Lejet për të fluturuar lëshohen për avionet që nuk plotesojnë ose nuk kanë treguar se plotesojnë specifiket e aplikueshme të certifikimit por janë në gjendje të kryejnë fluturime të sigurta sipas kushteve të përcaktuara.

21A.174 Aplikimi

(a) Në bazë të 21A.172, një aplikim për një certifikatë të vlefshmerise ajrore bëhet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga DPAC.

(b) Secili aplikim për një certifikatë vlefshmerise ajrore ose certifikatë të kufizuar të vlefshmerise ajrore përfshin:

1. klasa e certifikates se aftësisë për të fluturuar për të cilën është aplikuar;

2. në lidhje me një avion të ri:

(i) një deklaratë konformiteti:

- e lëshuar sipas 21A.163(b), ose

- e lëshuar sipas 21A.130 dhe e vlefësuar nga DPAC,

- ose, për një avion të importuar, një deklaratë që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga DPAC, të nënshkruar nga autoriteti eksportues

(ii) Një raport të peshës dhe balancës me një skedule të ngarkesës.

2. Ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te dytë, periudha e veprimeve korrigjuese e dhëne nga DPAC do jetë e përshtatshme me natyrën e konkluzioneve por ne çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashte muaj. Ne disa rrethana dhe ne varësi te konkluzioneve, DPAC mund ta zgjasë periudhën gjashte mujore ne një plan te kënaqshëm veprimi te masave korrigjuese për te cilin bihet dakord nga DPAC.

3. Konkluzionet e nivelit te tretë nuk kërkojne që te ndërmerren veprime te menjëherëshme nga mbajtësi i miratimit te organizatës prodhuese.

(d) ne rast se arrihen konkluzione te nivelit te dytë, miratimi i organizatës prodhuese mund te jetë subjekt i një kufizimi te pjesshëm ose te plote, pëzullimi ose shfuqizimi sipas 21B.145.

Mbajtësi i miratimit te organizatës prodhuese konfirmon ne kohë marrjen e njoftimit te kufizimit, pezullimit ose te shfuqizimit te letrës së marrëveshjes.

21A.159 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

(a) Miratimi i organizatës prodhuese lëshohet për një kohëzgjatje te pakufizuar. Mbetet i vlefshëm përvece kur:

1. Organizata prodhuese nuk demonstroi përputhshmëri me kërkesat e zbatueshme ne kete Nenpjesë; ose

2. DPAC pengohet nga mbajtësi ose ndonjë partner ose nenkontraktor i tij te kryejte investigimet ne përputhje me 21A.257; ose

3. Ekzistojne prova që organizata prodhuese nuk mund te mbaje një kontroll te kënaqshëm te prodhimit te produkteve, pjesëve ose pajisjeve sipas miratimit; ose

4. Organizata prodhuese nuk i ploteson më kërkesat e 21A.133; ose

5. Çertifikata është dorëzuar ose shfuqizuar 21B.245.

(b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, çertifikata i kthehet DPAC.

21A.163 Privilegjet

Ne vijim te kushteve te miratimit te lëshuara sipas 21A.135, mbajtësi i një miratimi te organizatës prodhuese mund:

(a) Te kryejte aktivitete prodhuese sipas kësaj Pjesë.

(b) Ne rast te një avioni te përfunduar dhe me paraqitjen e një Deklarate Konformiteti (Formulari EASA 52) sipas 21A.174, te marrë një certifikate avioni te vlefshmerise Ajrore dhe një certifikate te zhurmës pa prova te mëtejshme.

(c) Ne rast te produkteve, pjesëve ose pajisjeve te tjera te lëshojë çertifikata te autorizuara te shitjes (Formulari EASA 1) sipas 21A.307 pa prova te metejshme.

(d) Te mirembajë avionin e ri që ka prodhuar dhe te lëshoje një çertifikatë te lejimit për te sherbyer (Formulari EASA 53) ne lidhje me ate mirëmbajtje.

21A.165 Detyrimet e mbajtësit

Mbajtësi i një miratimi te organizatës prodhuese:

(a) Siguron që ekspozija e organizatës prodhuese e siguruar ne përputhje me 21A.143 dhe dokumentat te cilave i referohet përdoren si dokumente bazë pune brënda organizatës.